



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 101 / 2 prot

Vau Dejes me 08 / 08 / 2017

KONTRATË PËR MBIKQYRJE  
PUNIMESH

E lidhur sot me datë 08 / 08 / 2017 në Bashkinë Vau Dejes ndërmjet paleve kontraktuese

**INVESTITORI:** Bashkia Vau Dejes, me NIPT K567050070, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z.Zef HILA.

**MBIKQYRESI :** ARENA M.K me NIPT L67619801Q, me nr license MK 2892, me përfaqësues ligjor Z.Endrit Myrtaj

**OBJEKTI I KONTRATES :** Supervizim i Bashkëfinancimit "Gjelberim i mjediseve publike të Bashkisë Vau Dejes"

**BAZA LIGJORE :**

- Ligji Nr.8402 date 10.09.1998 kreu III nenet 7,15 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar
- VKM 354 datë 11.05.2016 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim , Mbikqyrje dhe Kolaudim.

**Data e fillimit te mbikqyrjes** se punimeve eshte data 08.08.2017 dhe perfundimi, 30 dite kalendarike nga data e fillimit.

Gjuha me te cilen lidhet kontrata eshte gjuha shqipe.

Vlera e kontrates eshte **96.000( nënëtdhjetë e gjashtë mijë) lekë**, ne mbeshtetje te V.K.M. Nr.704 date 29.10.2014.

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe kohe prej 30 dite kalendarike nga data e fillimit te punimeve ne objekt.

Komunikimi ndërmjet paleve behet vetem me shkrim. Njoftimi behet efektiv vetem pasi dorezohet.

Nga lidhja e kesaj kontrate percaktohen te drejtat e detyrimit ndërmjet paleve "detyrime te ndersjellta, kushtet e punes, etj." si me poshte :

I- PER MBIKQYRESIN E PUNIMEVE



1.-Mbikqyresi/ i punimeve do te punesoje personelin e nevojshem per kryerjen e detyrave te percaktuara ne programin e mbikqyrjes se punimeve.

2.-Mbikqyresi/ i punimeve pergjigjet per zbatimin e kontrates te sipermarrrjes te punimeve me vlerë: 95,640,000.00 (nëntëdhjetë e pesë milion e gjshtëqind e dyzet mijë) lekë te lidhur ndermjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Vau i Dejes e perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise Z. Zef HILA dhe Kontraktorit ARENA M.K me NIPT L67619801Q, me nr license MK 2892, me perfaqesues ligjor Z.Endrit Myrtaj me adrese kryesore Fier QENDER, Mallakaster Dukas, rruga nacionale Ballsh Fier, NDERTESA PRIVATE Nr 2 zone kadastrale 156 , nr pasurie 93/14

### 3.1

3.2 Vlera e fondit pa tvsh financohet nga te ardhurat dhe transferta e Bashkise Vau Dejes.

3.-Mbikqyresi i punimeve vihet ne dijeni nga investitori per nenkontraktuesit qe zgjedh sipermarresi,ne perputhje me kontraten e nenshkruar.

4.-Mbikqyresi i punimeve perveç sherbimeve te kontrollit per zbatimin e punimeve, ndjek edhe zbatimin e grafikut te punimeve.

5.-Mbikqyresi i punimeve mban edhe dokumentacionin e meposhtem :

a.-Vendimin e K.RR.T.- se per sheshin ose lejen e ndertimit dhe lejen origjinale te ndertimit.

b.-Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi,nga Bashkia ose nga Keshilli i Qarkut sipas juridiksionit.

c.-Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik te themeleve,te bazamenteve dhe te punimeve te maskuara.

d.-Dokumentacionin perkates per te gjitha ndryshimet e mundeshme qe mund te jene bere ne projekt-preventiv gjate zbatimit te objektit,pa prekur kushtet e vena ne vendimin e K.RR.T.-se,te gjitha keto te miratuara detyrimisht nga projektuesi si dhe nga investitori duke u shoqeruar edhe me relacionin tekniko-ekonomik.

e.-Planin e organizimit te punimeve.

6.-Mbikqyresi i punimeve duhet te kontrolloje periodikisht dhe ne fazat kryesore librin e kantjerit,saktesine dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te.

7.-Mbikqyresi i punimeve ne çastin e fillimit te punimeve duhet te beje verifikimet paraprake si me poshte vijojne :

a.-Verifikimin e te gjithë dokumentacionit paraprak si licenca,autorizime,leje,etj. te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.

b.-Verifikimin e sheshit te ndertimit,ne se eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet.

c.-Njohjen me hollesi te kontrates te sipermarrrjes dhe e te gjitha akteve administrative qe lidhen me te,si dhe me njohjen e te gjitha ndryeshimeve te mundeshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.

d.-Vendosjen e tabelës se identitetit me te dhenat e meposhteme :


-emertimin e objektit-data e marrjes se lejes se ndertimit-investitori-projektuesi-sipermarresi dhe drejtuesi teknik i punimeve te objektit-mbikqyresi i punimeve-afati i ndertimit-siperfaqja e ndertimit-lartesia-intensiteti sizmik i sheshit te ndertimit,ne baze te studimit sizmiologjik dhe mikrozonimit sizmik.

8.-Mbikqyresi i punimeve,pas verifikimeve te percaktuara sipas pikes se mesiperme”7”

harton dokumentacionin si me poshte:

-aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarrese-aktin e dorezimit nga sipermarresi te dokumentacionit teknik dhe administrativ si licensa,autorizime e leje te marra nga sipermarresi-shkresen me ane te se ciles njofton pushtetin vendor dhe Inspektoriatin Urbanistik Ndertimor Vendor per fillimin e punimeve.

9.-Mbikqyresi i punimeve,sa here qe e shoh te nevojshme gjate zbatimit te punimeve i jep me shkrim instruksione e urdhera sipermarresit dhe ky i fundit eshte i detyruar t'i zbatoje ato.Sipermarresi ruan te drejten per t'i bere me shkrim investitorit verejtjet e tija ne lidhje me instruksionet dhe urdherat e marra nga mbikqyresi i punimeve.



10.-Mbikqyresi i punimeve,me shpenzimet e sipermarresit ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materjaleve te vendosura ne objekt,te prodhimeve te gateshme e gjysem te gateshme me te cilat furnizohet objekti apo te strukturave b/arme e te elementeve tjere te objektit.

11.-Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose disa personave nga personeli i sipermarresit duke iu drejtuar me shkrim titullarit te shoqerise sipermarrese(drejtuesit ligjor apo administratorit te shoqerise) dhe duke i shpjeguar arsyet sipas kopetencave te tija.

12.-Mbikqyresi i punimeve kerkon verifikimet perkatese kur mendon se ka difekte ne zbatimin e punimeve dhe kur verifikimet i japin te drejte mbikqyresit te punimeve shpenzimet jane ne ngarkim te sipermarresit.

13.-Mbikqyresi i punimeve me miratim te investitorit ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet per zbatim teknik te gabuar apo per paafesi teknike zbatimi per aq kohe sa quhet e nevojshme korigjimi i gjendjes.

14.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut te hollesishem te punimeve dhe i raporton investitorit çdo muaj per realizimin e tij.

15.-E gjithë korespondenca e mbikqyresit te punimeve me investitorin dhe me sipermarresin perben dokumentacionin e objektit dhe si i tille ruhet me çdo kusht.

16.-Mbikqyresi i punimeve mban dosjen e mbikqyrjes se punimeve,ku pasqyrohen te gjitha aktet e mbajtura gjate zbatimit te punimeve te objektit qe nga akti i dorezimit te sheshit te ndertimit e deri ne pregatitjen e dokumentacionit per kolaudim objekti me qellim dhenien e kuadrit te plote te te gjitha fazave te zbatimit te punimeve.

17.-Mbikqyresi i punimeve pas marrjes se njoftimit me shkrim nga sipermarresi per perfundimin e punimeve i kerkon sipermarresit te punimeve dorezimin e dokumentacionit si me poshte :

\*kontraten dhe aktet qe lidhen me te.

\*proçes verbalet e fillimit,te nderprerjes ose te zgjatjes dhe te perfundimit te punimeve.

\*çertifikatat e provave laboratorike te materjaleve te perdorura te leshuara nga labororet e autorizuar per kete qellim.

\*deklaraten se objekti eshte ndertuar ne perputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Mbikqyresi i punimeve firmos gjithçka qe ka miratuar.Nje kopje e dokumentacionit te miratuar nga mbikqyresi i punimeve i dergohet kolaudatorit apo grupit te kolaudimit te objektit.

18.-Kur investitori lejon shmangie ne permasa ose cilesi te dobet qe nuk cenojne kushtet teknike e qe jane te pranueshme per vepren,mbikqyresi i punimeve do te zbatoje zbritje te çmimeve ne kontabilitet dhe ne vleresimin perfundimtar,por ne çdo rast me miratim te investitorit.

19.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon e miraton situacionet e paraqitura nga sipermarresi ne fazat e ndryshme te punimeve.Pagesa mund te kryhet vetem ne baze te ketij miratimi.

20.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon e miraton perdorimin e fondit rrezerve(n.q.s eshte parashikuar) te preventivit dhe i raporton periodikisht investitorit per gjendjen e tij.Ky i fundit,ne se ka vrejtje e njofton sipermarresin dhe problemi zgjidhet ndermjet tyre.Per çdo ndryshim te mundshem,mbikqyresi i punimeve vihet ne dijeni per te ndjekur zbatimin e ndryshimeve ne fjale.


21.-Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne kolaudimin e objektit,i pergjigjet dhe e sqaron kolaudatorin per te gjithë dokumentacionin dhe per te gjithë paqartesite qe ka ai per kolaudimin e objektit si dhe firmos proçes verbalin e kolaudimit.

22.-Pas perfundimit te kolaudimit,mbikqyresi i punimeve,mbeshtetur ne kontraten e sipermarrjes se zbatimit te punimeve dhe ne aktin e kolaudimit,percakton vleren perfundimtare te objektit e cila i behet e ditur sipermarresit dhe i jepet per likujdim investitorit.

23.-Me perfundimin e punimeve,brenda 30 diteve,mbikqyresi i punimeve duhet te depozitoje prane investitorit nje relacion ne dy kopje rreth zbatimit te punimeve dhe te kontrates te sipermarrjes te zbatimit te tyre.

24.-Ne rast se gjate zbatimit te punimeve per shkaqe te ndryshme del nevoja e shmangies nga projekti,mbikqyresi i punimeve i kerkon investitorit thirrjen e projektuesit dhe ne prezence detyrimisht te sipermarresit mbahet proçes verballi duke reflektuar me hollesi shkaqet dhe volumet shtese(hartohet preventivi shtese per punimet qe shtohen dhe per punimet qe pakesohen,i cili detyrimisht duhet te miratohet nga investitori.)

25.-Mbikqyresi i punimeve urdheron sipermarresin per te prishur e per te ribere,me shpenzimet e ketij te fundit,punimet qe nuk jane bere me cilesine e parashikuar dhe me materjale qe nuk permbushin standardet neqiptare apo ato europiane.



26.-Mbikqyresi i punimeve nuk duhet te lejoje qe asnje punim te mbulohet,maskohet apo te betonohet pa miratimin e tij.Sipermarresi i punimeve detyrimisht duhet te njoftoje mbikqyresin e punimeve kur punimet e mesiperme jane gati te ekzaminohen nga mbikqyresi i punimeve.

27.-Mbikqyresi i punimeve do te miratoje çdo propozim te sipermarresit per te zevendesuar personelin kryesor te punimeve vetem neqoftese pregatitja dhe aftesite e tyre te nevojshme jane krejtesisht te barabarta ose me te mira se ato te personelit te perfshire ne listen e stafit te shoqerise te paraqitur ne dokumentacionin e prokurimit te objektit.

28.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon e miraton programin e punimeve qe i paraqet sipermarresi i punimeve,nete cilin perfshihen metodat e pergjithshme,masat paraprake pregaditore,grafiku dhe afati per te gjitha veprimtarite e punimeve.

29.-Mbikqyresi i punimeve mund te shtyje daten e perfundimit te punimeve te objektit ne raste te kompensimit ose kur ndodh ndonje ndryshim qe e ben te pamundur perfundimin e punimeve dhe kolaudimin e pjesshem apo perfundimtar te punimeve brenda dates se caktuar ne kontrate per kete qellim,pa detyruar sipermarresin qe te marre masa per te shpejtuar punen e metejshme,gje qe do te shkaktonte shpenzime te tjera per sipermarresin

30.-Neqoftese sipermarresi nuk korigjon defektin e shfaqur te ndonje punimi dhe te njoftuar nga mbikqyresi i punimeve brenda afatit te percaktuar ne njoftim,mbikqyresi i punimeve do te vleresoje koston e korigjimit te defektit dhe sipermarresi do te paguaj kete shume ose investitori do te fitoje kete shume nepermjet zbritjes nga shuma qe i detyrohet sipermarresit.

31.-Mbikqyresi i punimeve do te kontrolloje punen e kryer nga sipermarresi dhe do te vertetoje shumen qe duhet t'i paguhet sipermarresit brenda 8(tete) diteve nga data e marrjes se çertifikates se pageses(situacionit) nga sipermarresi.Vlera e punes se kryer do te perfshije vlerat e ndryshimeve dhe rastet e kompensuara ne se keto do te jene te miratuara me pare nga investitori.

## II.- PER INVESTITORIN.

1.-Investitori i dorezon mbikqyresit te punimeve te objektit,ne momentin e lidhjes se kontrates per mbikqyrjen e punimeve,dokumentacionin si me poshte :

\*Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi,dhe nga titullari i Autoritetit Kontraktues Komuna Bushat.

\*Preventivin e ofertes fituese(te sipermarresit) te firmosur nga anetaret e komisionit te vleresimit te ofertave dhe te miratuar nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor.

\*Kontraten e lidhur ndermjet tij dhe sipermarresit per sipermarrjen e zbatimit te punimeve te objektit.

\*Specifikimet teknike te punimeve te objektit dhe pershkrimin e shkurter te tyre te shoqeruar me raportin teknik te projektuesit.

\*Kopje te vendimit te K.RR.T.-se per sheshin ose lejen e ndertimit dhe lejen e ndertimit te miratuar nga te gjithet subjektet juridike qe kane objektet e tyre brenda sheshit te ndertimit te objektit.

\*Nje pjese te dokumentacionit ligjor-administrativ te sipermarresit si licensa,stafi teknik,paisjet e makinerite qe do te perdoren,etj.

2.-Investitori i dorezon sipermarresit te punimeve nje kopje te kontrates te lidhur ndermjet investitorit dhe mbikqyresit te punimeve per mbikqyrjen e punimeve te objektit.

3.-Investitori duhet te njohe mbikqyresin e punimeve me çdo ndryshim qe mund t'i beje ai kontrates te lidhur me sipermarresin e zbatimit te punimeve.

4.-Investitori duhet te marre masa per lirimin e sheshitte ndertimit,ne se ai eshte i zene ne momentin e fillimit te punimeve.

5.-Investitori ben likujdimin e pageses per çdo situacion te paraqitur nga mbikqyresi i punimeve brenda 8(tete) diteve kalendarike nga dita e paraqitjes se situacionit pjesor ose progresiv apo perfundimtar per mbikqyrjen e punimeve.Per çdo dite vonese tej afatit te caktuar me siper investitori



i paguan mbikqyresit te punimeve nje demshperblim vonese prej 1% te vleres se situacionit te paraqitur per likujdim nga mbikqyresi i punimeve.

6.-Investitori kontrollon e miraton procesverbalin e preventivin shtese per punimet qe shtohen apo pakesohen ne rast se gjate zbatimit te punimeve per shkaqe te ndryshme lind nevoja e shmangies nga projekti apo qe jane parashikuar me pak ne preventivin fillestar.

7.-Investitori brenda 30(tridhjetë) diteve kalendarike nga data e marrjes se njoftimit nga sipermarresi i zbatimit te punimeve per perfundimin e punimeve te objektit,merr ne dorezim nga mbikqyresi i punimeve dosjen e objektit dhe i njofton atij daten e kolaudimit te punimeve te kryera sipas kontrates te sipermarrjes se zbatimit te punimeve te objektit

8.-Investitori mund qe brenda periudhes se efektshmerise se kontrates se lidhur me mbikqyresin e punimeve per mbikqyrjen e punimeve,te emeruje kolaudatorin apo grupin e kolaudimit,te cilet gezojne te drejten e mbikqyrjes dhe te kontrollit te punimeve gjate gjithë fazave te realizimit te tyre dhe te lejne detyra per korigjimin e te metavete konstatuara.

9.-Investitori mund te kerkoje largimin apo zevendesimin e mbikqyresit te punimeve kur verteton mangesi serioze ne veprimtarine e tij si :

\*Mangesi ne realizimin e detyrave te percaktuar ne piken "P" te kesaj kontrate.

\*Nderprerje e paarsyeshme te punimeve dhe zgjatje e theksuar pa shkak te tyre.

10.-Kur verehen shkelje te dispozitave ligjore,investitori ka te drejte te urdheroje mbikqyresin e punimeve per pezullimin e punimeve deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes.Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundra-vajtje administrative,vendosen sanksione,ne baze te neneve 15 dhe 16 te kreut III-te te ligjit Nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit".

11.-Ne qofte se me perfundimin e afatit te mbikqyrjes se punimeve te percaktuar ne kontraten e mbikqyrjes se punimeve,punimet e sipermarrjes se zbatimit te punimeve nuk perfundojne,investitori ka te drejte te hartoje kontrate shtese me mbikqyresin e punimeve me afat kohor deri ne perfundim te punimeve te sipermarrjes se zbatimit te tyre,me vlere shtese mbi ate te percaktuar ne kontraten fillestare per mbikqyrjen e punimeve te objektit.

Ne qofte se ai(investitori) nuk vepron keshtu,atehere kontrata e mbikqyrjes se punimeve quhet e perfunduar dhe nga mbikqyresi i punimeve ai(investitori) merr ne dorezim dosjen e mbikqyrjes se punimeve te objektit.

12.-Investitori duhet t'i pergjigjet me shkrim kerkesave,vrejtjeve e sygjerimeve te mbikqyresit te punimeve brenda kohes se domosdoshme per te mos vonuar vazhdimin e punimeve ose zbatimin e tyre pa miratimin e tij(investitorit).

### III.- TE PERBASHKETA.

1.-Investitori ose mbikqyresi i punimeve mund te pezullojne zbatimin e kontrates se mbikqyrjes se punimeve,ne qofte se pala tjetër ben shkelje themelore te kontrates.

Shkelje themelore te kontrates perbejne :

\*Mbikqyresi i punimeve lejon nderprerjen e punimeve nga sipermarresi per raste kur nuk eshte parashikuar ne programin e punimeve.



\*Mbikqyresi i punimeve urdheron pezullimin e perkohshem te punimeve dhe ky urdher pa shkak nuk terhiqet prej tij brenda 15 diteve.

\*Mbikqyresi i punimeve falimenton.

\*Mbikqyresi i punimeve lejon mos korigjimin e defektit brenda afatit te percaktuar prej tij.

\*Investitori lejon zgjatjen pa arsye te afatit te perfundimit te punimeve te percaktuar ne kontraten e mbikqyrjes se punimeve dhe ne kontraten e siper marrjes se zbatimit te punimeve me shume se 25% te afatit fillestar kohor te perfundimit te punimeve.

\*Investitori kur ka arsye objektive, mund te prishe kontraten e lidhur me mbikqyresin e punimeve per mbikqyrjen e punimeve te objektit duke i dhene mbikqyresit te punimeve nje njoftim brenda nje afati prej 15 ditesh.

2.-Investitori dhe mbikqyresi i punimeve do te bejne perpjekje per te zgjidhur ne menyre paqesore, nepermjet bisedimeve te drejtperdrejta çdo mosmareveshje qe lind midis tyre ose lidhur me zbatimin e kontrateve si te zbatimit te punimeve ashtu dhe te mbikqyrjes se punimeve, ne te kundreten keto mosmareveshje zgjidhen nepermjet gjykates.

3.-Ne qofte se pas dates se lidhjes se kontrates per mbikqyrjen e punimeve te objektit ndodhin ndryshime ne ligj, dekret, vendim, udhezim apo akt tjeter nenligjor i Kuvendit apo i Keshillit te Ministrave, qe shkaktojne ndryshime ne shpenzimet e mbikqyresit te punimeve per zbatimin e kontrates, keto ndryshime shpenzimesh do te percaktohen nga investitori duke hartuar kontrate shtese.

Kjo kontratë nuk mund të interpretohet dhe përdoret nga palët si mjet për t'u shmangur nga detyrimet që parashikohen në ligje dhe aktet nënligjore që rregullojnë mbikëqyrjen e punimeve dhe që janë direkt të zbatueshme për palët në këtë kontratë.

-Kontrata e perpiluar dhe e miratuar nga te dy palet mbahet ne 4 (kater) kopje, ku nje kopje i dorezohet mbikqyresit/kolaudatorit te punimeve dhe kopjet tjera terhiqen nga ana e investitorit.

#### PËR MBIKQYRESIN E PUNIMEVE



PËR INVESTITORIN  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
KRYETARI  
ZEF HILA

